



**BASHKIA
TIRANË**

KESHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 74, datë 26.07.2017

PËR

“ DEKLARIMIN E MBARIMIT TË MANDATIT PARA KOHE TË ANËTARIT TË KËSHILLIT BASHKIAK ZONJËS FLOIDA KËRPAÇI DHE DHËNIEN E MANDATIT KANDIDATIT TË RADHËS, ZONJËS GENTA MEZINI”.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 49, pika 1, 2 dhe 5, si edhe neni 54, germa “j”, si edhe vendimit nr. 557, datë 26.07.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetë deklarimit të kandidatëve nga listat shumëemërore për këshillat bashkiak në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, me propozim të Komisionit të Mandateve, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të pranojë dorëheqjen e zonjës Floida Kërpaçi, anëtare e Këshillit Bashkiak të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim dhe të deklarojë mbarimin e mandatit para kohe si anëtarë i Këshillit Bashkiak.
2. T’i japë mandatin e anëtarit të Këshillit Bashkiak Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, zonjës Genta Petrit Mezini.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

ALDRIN DALIPI